

“TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË”

Bashkia Urë Vajgurore

Kjo analizë u përgatit nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, në emër të Rrjetit të Organizatave “Zëri i të Rinjve”, me mbështetjen e UNFPA-së.



Mars 2020



Autor:

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve



© Aplikimet për leje për të shumëfishuar ose përkthyer pjesë nga ky publikim duhet të dërgohen në:

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve
Rruga "Brigada e VIII", Pall. LID, K.1, Z.1, Tiranë, Shqipëri
Email: info@observator.org.al
Webmail: www.observator.org.al

Ky Publikim është realizuar nga UNFPA me ekspertizën e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori), në kuadër të projektit "Leave No One Behind" ("Askush të mos Mbetet Pas"), një Program i përbashkët i OKB-së i financuar nga Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) dhe zbatuar nga katër agjensi të OKB: UNDP, UNFPA, UNICEF, dhe UN WOMEN në partneritet me Qeverinë Shqiptare. Ky projekt synon fuqizimin e personave vulnerabel në Shqipëri që të kenë akses të barabartë në shërbimet dhe mundësitë publike, të kenë një zë në vendimmarrjen publike, që ndikon në jetën e tyre dhe t'i kërkojnë llogari zyrtarëve publikë, duke i mbajtur përgjegjës për dështimet apo arritjet.

Një falenderim i shkon stafit të Bashkisë së Urës Vajgurore, që ka bashkëpunuar me Observatorin dhe ka mundësuar të dhënat ndër vite mbi aktivitetet dhe buxhetin e planifikuar për të rejtat dhe të rinjtë. Në veçanti, falenderojmë Znj. Juliana Memaj – Kryetare e Bashkisë Urë Vajgurore, Znj. Nerita Heqimi – Drejtore e Shërbimeve Sociale në Bashkinë Urë Vajgurore.

Përmbajtja e këtij Publikimi është përgjegjësi e Observatorit, në emër të Rrjetit të Organizatave "Zëri i Rinjve". Opinionet e shprehura këtu janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionet e UNFPA-së, UN Albania apo SDC.

PËRSE BUXHETIMI “PËR RININË” DHE “ME RININË”?

Rinia në Shqipëri është pjesë e programit dhe politikave të qeverisë dhe citohet si grup prioritar në dokumenta të veçantë të hartuar për këtë qëllim. Ofrimi i një tërësie shërbimesh dhe informacionesh edukuese në fushën e shëndetësisë, arsimit, punësimit, zhvillimit ekonomik, kulturës, sportit, argëtimit, mjedisit e vullnetarizimit, si dhe angazhimi i rinisë në proceset planifikuese e vendimmarrëse, është domosdoshmëri¹. Këto shërbime mund dhe duhet të ofrohen kryesisht nga njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore (bashkitë), të cilat janë më afër qytetar/eve dhe njohin më mirë nevojat e tyre.

Të rejtat dhe të rinjtë duhet të jenë pjesë e iniciativave planifikuese e zhvilluese të ndërmarra si në nivel qendror, ashtu edhe nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sidomos nga bashkitë.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë detyra dhe kompetenca specifike për rininë, të diktuar nga ligje të ndryshme dhe plane strategjike kombëtare. **Më poshtë paraqiten kompetencat për rininë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore:**

- Ligji 139/2015** “Për vetëqeverisjen vendore” si një nga ligjet bazë mbi të cilin organizojnë punën dhe funksionojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore, ka të shprehur qartësisht detyrimin dhe përgjegjësinë për trajtimin me prioritet të rinisë. Konkretisht këto detyrime evidentohen në:
 - Nenin 3*, ku përcaktohet misioni i vetëqeverisjes vendore, në pikat d), dh) dhe f) sipas të cilave realizimi i shërbimeve duhet të bëhet në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e antar/eve të bashkësisë, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj apo akte të tjera normative, si dhe përmes nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
 - Nenin 23*, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike (kryesisht në mirëmbajtjen e institucioneve arsimore apo zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në fushën e shëndetësisë, etj);
 - Nenin 24*, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e shërbimeve sociale;
 - Nenin 25*, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese;
 - Nenin 26*, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
 - Nenin 28*, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e zhvillimit ekonomik vendor;
 - Nenin 29*, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e sigurisë publike.

Garantimi i pjesëmarrjes publike të grupeve të ndryshme shoqërore në procesin e vendimmarrjes shprehet qartësisht edhe në nenin 16 të këtij ligji, ku përcaktohet detyrimi për konsultime publike nga Njësitë e vetëqeverisjes vendore.

- Ligji 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”**, i cili në:

- Nenin 38*, pika 2 përcakton që pas finalizimit të projekt dokumentit të programit buxhetor afatmesëm

1. Fushat e mësipërme përbëjnë dhe thelbin e objektivave të përgjithshme të Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015-2020

të rishikuar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore të marrë masa për publikimin e tij dhe më pas të organizojë seanca dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit². Në këtë kuadër, bashkitë mund dhe duhet të mbështetin iniciativat planifikuese buxhetore për të rejtat dhe të rinjtë në linjë me nevojat e këtij grupi, duke u udhëhequr dhe zbatuar legjisllacionin në fuqi dhe dokumentat kryesorë strategjikë të hartuar për këtë qëllim.

3. Ligji 75/2019 “Për rininë”, si një ligj bazë për mbrojtjen e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse, krijimin e kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve, përcaktimin e funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, si dhe bashkëpunimin me organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë. Kompetencat e njësisë së vetëqeverisjes vendore për rininë në këtë ligj përcaktohen në:

(i) Nenin 5, ku theksohet se njësia e qeverisjes vendore duhet të:

- Bashkëpunoj me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) për politikatat, projektet e programet në fushën e rinisë;
- Kontriboj në ofrimin e veprimtarive për të rinjtë në bashkëpunim me MASR, institucione dhe autoritete të tjera vendore, duke përcaktuar standardet në ofrimin e veprimtarive rinore dhe punës me rininë.

(ii) Nenin 7, ku përcaktohen kompetencat specifike të njësisë të vetëqeverisjes vendore, si më konkretisht:

- Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me funksionet e tyre, hartojnë dhe zbatojnë politikatat vendore në fushën e rinisë, si dhe janë përgjegjëse për:
 - pasqyrimin dhe respektimin e të drejtave të të rinjve, duke përcaktuar objektivat dhe prioritetet, si dhe të garantojnë zbatimin e tyre;
 - krijimin e këshillit vendor të rinisë;
 - organizimin dhe koordinimin e veprimtarive që synojnë arritjen e objektivave vendore në fushën e mbrojtjes dhe të fuqizimit të të rinjve;
 - organizimin dhe ofrimin e veprimtarive për të mbështetur mirëqenien dhe zhvillimin e të rinjve;
 - nxitjen e vullnetarizmit të të rinjve dhe edukimin joformal të tyre;
 - financimin e krijimit dhe të zhvillimit të infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta;
 - krijimin e strukturave administrative për çështjet e rinisë;
 - parashikimin, në buxhetet e tyre, të fondeve për realizimin progresiv të të drejtave të të rinjve për zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive rinore;
 - mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave, në bashkëpunim me institucionet e tjera, për situatën e të drejtave të të rinjve në territorin e tyre.
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të aplikojnë për t’u mbështetur nga programet kombëtare dhe ndërkombëtare për rininë, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në fuqi.
- Për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në këtë nen, njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve të përbashkëta, në përputhje me legjisllacionin në fuqi për vetëqeverisjen vendore.
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë me organizatat për të rinjtë e organizatat rinore shqiptare

2. Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 38, pika 2, fq. 16

në diasporë, për të mbajtur komunikimin me të rinjtë shqiptarë që janë larguar nga vendi për arsye studimesh ose të tjera, me qëllim angazhimin në aktivitetet që zhvillohen në Republikën e Shqipërisë.

(iii) *Nenin 10*, ku përcaktohet se:

- Këshilli vendor i rinisë është organ këshillimor, që funksionon pranë kryetarit të bashkisë. Këshilli vendor i rinisë ushtron kompetencat e mëposhtme:
 - këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;
 - vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor;
 - propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë;
 - bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë.
- Këshilli vendor i rinisë kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe përbëhet nga të paktën 4 deri në 6 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë. Anëtarët e këshillit vendor të rinisë emërohen me urdhër të kryetarit të bashkisë.
- Kriteret, procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të këshillit vendor të rinisë, si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të këshillit vendor të rinisë miratohen me vendim të këshillit bashkiak, duke i'u referuar, për aq sa është e mundur, kriterëve dhe procedurave të miratuara nga Këshilli i Ministrave për Këshillin Kombëtar të Rinisë.

4. Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë (PKVR) 2015-2020, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 383, datë 6 maj 2015, është një ndër dokumentat kryesorë që udhëheq punën e qeverisjes qendrore, si dhe të njëjste të vetëqeverisjes vendore për veprime dhe masa për të rejtat dhe të rinjtë në Shqipëri. Qëllimi i këtij plani është zhvillimi dhe koordinimi i politikave ndërsektoriale rinore në edukim, punësim, shëndetësi e kulturë, si dhe forcimi i pjesëmarrjes së të rejave e të rinjve në jetën shoqërore dhe proceset vendimmarrëse. Misioni i Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015-2020 qartësisht evidenton nevojën për *“përmirësim të cilësisë së jetës së të rejave e të rinjve dhe forcim të statusit të tyre, përmes zhvillimit të më shumë mundësive në edukim, punësim, shëndetësi, kulturë, si dhe rritje të pjesëmarrjes së plotë të tyre në shoqëri dhe vendimmarrje”*⁶. Bazuar mbi këtë dokument strategjik, njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të hartojnë dhe zbatojnë planet e tyre të veprimit në nivel vendor, duke synuar përmbushjen e misionit dhe qëllimit të sipërcituar.

SI PARAQITET SITUATA NË BASHKINË URË VAJGURORE?

Në planifikimet dhe ndërhyrjet në shërbim të komunitetit, pra përfshirë edhe rininë, Bashkia Urë Vajgurore orientohet, veç të tjerash, përmes: (i) Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, (ii) Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Urë Vajgurore 2017, (iii) Planit të Përfshirjes Sociale 2018-2022 dhe (iv) Planit të Kujdesit Social 2019-2023. Ndërsa në terma buxhetorë, Bashkia Urë Vajgurore vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe përgatit Programin Buxhetor Afatmesëm, mbi bazën e të cilit, në përputhje me ligjin për financat e vetëqeverisjes vendore, bëhet dhe planifikimi buxhetor vjetor. Aktualisht Bashkia Urë Vajgurore ka në zbatim Programin Buxhetor Afatmesëm 2018-2020.

Bazuar në informacionin e dhënë nga bashkia, situata në lidhje me të rejat dhe të rinjtë paraqitet si në vijim:

- Bashkia Urë Vajgurore nuk ka një bazë të saktë të dhënash (databazë) në lidhje me numrin e të rejave dhe të rinjve në qytet dhe zonat rurale pjesë e territorit të bashkisë.
- Në Urën Vajgurore ka gjithsej 4 (katër) shkolla të mesme, nuk ka shkolla profesionale, nuk ka universitet, nuk ka qendër rinore dhe është në funksionim 1 (një) qendër multi-funksionale.
- Në këtë Bashki ka 2 organizata lokale, New Bridges dhe Youth Innovation Center, që kanë në fokus të punës së tyre dhe çështjet rinore.

• **Bashkia e Urës Vajgurore nuk ka të krijuar një Bord/ Këshill Rinor** që funksionon pranë Bashkisë.

• **Nuk ekziston një plan sektorial për shëndetësinë dhe/ apo një Plan sektorial për rininë**, por disa prej çështjeve kryesore janë të mbuluara në Planin e Kujdesit Social të Bashkisë së Urës Vajgurore 2019–2023.

• **Në Planin e Kujdesit Social Lokal të Bashkisë së Urës Vajgurore**, kategoritë e parashikuara për një vemendje sociale nga ana e Bashkisë janë: familjet e varfëra, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët në rrezik (nga familjet e varfëra, në situatë rruge, që punojnë, me aftësi të kufizuara), gratë me probleme sociale dhe dhuna në familje, komuniteti Rom dhe Egjiptian, familjet e pastreha. Në këtë plan, për të rinjtë janë parashikuar disa aksione, si më poshtë:

- Me qëllim përmirësimit e shërbimeve sociale në territorin e Bashkisë së Urës Vajgurore, një ndër objektivat strategjike lidhet me ofrimin e shërbimeve për fuqizimin e të rinjve. Disa prej aktiviteteve të parashikuara për fuqizimin e të rinjve janë:
 - Përfshirja e të rinjve në aktivitete vullnetare (indikator: Aktivitete vullnetarizmi organizuar nga klubet rinore);
 - Ndërmjetësim për trajnime dhe kurseve të formimit profesional për të rinjtë e papunë (indikator: 80 të rinj përfundojnë kurse profesionale);
 - Shërbime ndërmjetësimi nëpërmjet zyrës së punës për punësimin e të rinjve të papunë (indikator: Marrëveshje bashkëpunimi mes Bashkisë/ Njësisë Administrative me Zyrën e Punës);
 - Organizimi i fushatave ndërgjegjëse për parandalimin e përdorimit të drogës dhe alkoolit nga të rinjtë (indikator: një fushatë ndërgjegjëse e realizuar çdo vit në çdo shkollë të ciklit të ulët dhe të mesëm).

Në Planin e Kujdesit Social, janë listuar aktorët e mëposhtëm si përgjegjës për ofrimin e shërbimeve për fuqizimin e të rinjve:

- Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki;
- Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional;
- Njësitë Administrative;
- Zyra Rajonale e Punës;
- Organizatat Jo-fitimprurëse;
- Zyra e punës.
- Me qëllim planifikimin dhe ofrimin e programeve parandaluese, një ndër objektivat strategjike lidhet me *ritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të grupeve të rrezikuara*. Disa prej aktiviteteve të parashikuara për programet parandaluese për të rinjtë janë:
 - Organizimi i aktiviteteve edukuese dhe sensibilizuese për të rinjtë në shkolla kundër diskriminimit dhe bullizmit (indikator: 10 fushata dhe 20 aktivitete).
- Me qëllim krijimin e shërbimeve komunitare të integruara për komunitetin Egjiptian, një ndër aktivitetet

e planifikuara lidhet me *ofrimin e programeve fuqizuese të formimit profesional*. Një ndër indikatorët e matjes së progresit është zbatimi i programeve të ndryshme për 80 të rinj të komunitetit.

- **Në Planin e Kujdesit Social të Bashkisë Urë Vajgurore**, shërbimi shëndetësor është planifikuar si një zë i veçantë i përbërë nga 9 Qendra Shëndetësore dhe 29 ambulanca. Në këtë Plan (fq 16) citohet se në bazë të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Bashkia vepron dhe në fushën e shërbimeve shëndetësore, si një prej fushave të shërbimeve në bazë të funksioneve të qeverisë vendore, duke specifikuar *“Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimi i aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj”*.
- Në vitet e fundit Bashkia Urë Vajgurore ka zbatuar programe të ndryshme për përfshirjen e të rinjve në aktivitete të ndryshme social –kulturore që zhvillon bashkia, ka ndërmarrë nisma të ndryshme si psh: mbjellje pemësh, pastrim territori etj. Bashkia e Urës Vajgurore ka nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit 2 vjeçare me nr.prot 3181, datë 20.11.2019 me **Observatorin, në emër të rrjetit të organizatave “Zëri i të Rinjve”**, me qëllim mobilizimin, integrimin dhe fuqizimin e potencialeve të të rejave dhe të rinjve përmes shërbimeve ndërgjegjësuese, informuese, avokuese e lobuese, në fushat e edukimit, kujdesit, shëndetit dhe punësimit.
- Bashkia Urë Vajgurore **nuk ka njësi apo punonjës të veçantë dedikuar për shëndetin publik, sikurse nuk ka punonjës të veçantë dedikuar rinisë.**
- Sipas Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020 në Bashkinë e Urës Vajgurore kategoria e të rinjve nuk është e buxhetuar në mënyrë direkte nëpërmjet aktiviteteve dhe programeve apo shërbimeve të caktuara.
- Buxheti i bashkisë dedikuar indirekt për rininë **është pjesë e programeve buxhetore**, që paraqiten në tabelën në vijim:

Viti	Kategoria	Buxheti i planifikuar (Lekë) (c = a + b)	Shpenzime personeli (a)	Shpenzime korrente dhe Investime (b)	% që programi zë ndaj totalit të buxhetit
2018	Programi nr. 11 - Edukimi dhe sporti	27,224,000	0	27,224,000	3.8%
	Programi nr. 12 - Arti, kultura dhe turizmi	5,000,000	0	5,000,000	0.7%
	Programi nr. 15 & 16 - Shërbimet sociale	137,995,000	3,895,000	134,100,000	19.5%
2019	Programi nr. 11 - Edukimi dhe sporti	15,992,900	0	15,992,900	2.2%
	Programi nr. 12 - Arti, kultura dhe turizmi	5,270,000	0	5,270,000	0.7%
	Programi nr. 15 & 16 - Shërbimet sociale	145,446,000	4,105,000	141,341,000	19.9%
2020	Programi nr. 11 - Edukimi dhe sporti	17,640,000	0	17,640,000	2.2%
	Programi nr. 12 - Arti, kultura dhe turizmi	5,813,000	0	5,813,000	0.7%
	Programi nr. 15 & 16 - Shërbimet sociale	160,428,000	4,528,000	155,900,000	20.4%

Sikurse shikohet nga të dhënat e tabelës së mësipërme:

- **Planifikimi i buxhetit për programin e edukimit dhe sportit ka ardhur duke u ulur** nga viti 2018 (27,224,000) në vitin 2020 (17,640,000). Ndërkohë planifikimi i fondeve për këtë program, në raport me buxhetin e planifikuar për vitet 2018–2020, **ka ardhur duke u ulur me 1.6%** (nga 3.8% në vitin 2018 në 2.2% në vitin 2020).
 - **Planifikimi i buxhetit për programin e artit, kulturës dhe turizmit ka ardhur duke u rritur** nga viti 2018 (5,000,000) në vitin 2020 (5,813,000). Ndërkohë planifikimi i fondeve për këtë program, në raport me buxhetin e planifikuar për vitet 2018–2020, **ka mbetur i njëjtë me 0.7%**.
 - **Planifikimi i buxhetit për programin e shërbimeve sociale ka ardhur duke u rritur** nga viti 2018 (137,995,000) në vitin 2020 (160,428,000). Ndërkohë planifikimi i fondeve për këtë program, në raport me buxhetin e planifikuar për vitet 2018–2020, **ka ardhur duke u ulur me 0.9%** (nga 19.5% në vitin 2018 në 20.4% në vitin 2020).
- Njoftimet e ndryshme mbi çështjet sociale, shëndetësore, arsimore etj pasqyrohen online në faqen e internetit të bashkisë së Urës Vajgurore: www.uravajgurore.gov.al
 - Bashkia **nuk ka bërë ndonjë vlerësim/ anketim për të identifikuar nevojat dhe prioritetet** e të reja dhe të rinjve në Urën Vajgurore. Këshilli Bashkiak **nuk ka organizuar ndonjë seancë dëgjimore të veçantë për problemet e rinisë** por të rejtat dhe të rinjtë ftohen të jenë të pranishëm në seancat dëgjimore që organizohen në përgjithësi për problematikat e qytetit. Kur pyetet për rëndësinë e aktiviteteve me fokus shëndetin seksual e riprodhues, si dhe ato sensibilizuese për shëndetin dhe kujdesin shëndetësor, bashkia i vlerëson si aktivitete të rëndësishme, së bashku me: krijimin e Bordeve/ Këshillave konsultues të përbashkët ndërmjet bashkisë dhe organizatave rinore; pasjen e një manuali shpjegues për të rejtat e të rinjtë për t'u njohur me të drejtat e tyre mbi shëndetin e kujdesin shëndetësor; shkëmbimin e eksperiencave mes të reja dhe të rinjve nga bashki të ndryshme me ndërmjetësimin e drejtuesve vendorë, e të tjera.

Ndërkohë, nga një anketim i kryer nga UNFPA me ekspertizën e Observatorit, me 100 të reja e të rinj të bashkisë Urë Vajgurore (55% vajza dhe 40% nga Njësitë Administrative të Urës Vajgurore), gjatë periudhës nëntor 2019, rezultojnë se:

- Afërsisht **1 në 5 të reja dhe të rinj** kanë dëgjuar se çfarë janë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (Sustainable Development Goals - SDGs). **Interneti** (57%) është burimi kryesor i informacionit për të rinjtë në zonat urbane për pasurimin e njohurive të tyre mbi këtë çështje. Interneti dhe televizioni (38% për secilin) janë burimi kryesor i informacionit për të rinjtë në zonat rurale. **Gjithashtu shkolla** është një burim informacioni mbi SDGs nga të rinjtë e anketuar në zonat urbane (29%) dhe rurale (13%). Asnjë prej të rinjve të anketuar në zonat urbane dhe rurale nuk është shprehur se ka dëgjuar për SDGs nga familja.
- Një pjesë shumë e ulët e të rinjve të anketuar (**7% e grupmoshave 15-29 vjeç**) janë shprehur se **janë përfshirë personalisht për arritjen e SDGs**. Një pjesë e të rinjve të grupmoshave të ndryshme (8% e rasteve) janë shprehur se nuk janë përfshirë personalisht në arritjen e SDGs. **3% e të rinjve (të grupmoshës 15-18 vjeç) shprehen se dëshirojnë të përfshihen**, por nuk kanë informacionin e nevojshëm se si mund të ndodhë kjo gjë.
- **1% të anketuarve shprehen se nuk kanë marrë ndonjëherë informacion** mbi shëndetin seksual dhe riprodhues (1 djal nga zonat rurale).
- **Shumica e të rinjve (58%) shprehen se informacioni i marrë në shkollë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues është pjesërisht i mjaftueshëm. 26% e të reja dhe të rinjve në zonat urbane shprehen se informacioni i**

marrë në shkollë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues është ***i mjaftueshëm***, përkundrejt **20% të të rejave dhe të rinjve në zonat rurale**.

- **68% e të rejave dhe të rinjve në zonat rurale** dhe **38% e të rejave dhe të rinjve në zonat urbane nuk flasin me prindërit** e tyre mbi çështjet e shëndetit seksual dhe riprodhues. 10% e të rinjve (8% në zonat rurale dhe 2% në zonat urbane) që shprehen se nuk mund të flasin për këtë tematikë me prindërit.
- **1 në 2 të reja dhe të rinj** janë në dijeni të programeve/ prioriteteve të bashkisë (më shumë njohuri kanë kryesisht vajzat dhe djemtë në zonat urbane). Ndërsa grupi më pak i informuar janë djemtë nga zonat rurale në masën 18%.
- Shumica e të rejave dhe të rinjve (70% në zonat rurale) shprehen se **nuk kanë marrë ndonjëherë pjesë në takimet** që bashkia ka zhvilluar me të rejtat dhe të rinjtë për përcaktimin e prioriteteve të zhvillimit të zonës. Një pjesë e konsiderueshme (45% e të rinjve nga zonat urbane) shprehen se kanë marrë pjesë ndonjëherë. Portali online (për 32% të të rejave dhe të rinjve të zonave urbane) dhe faqja zyrtare e Bashkisë (për 48% të të rejave dhe të rinjve nga zonat rurale) janë mjetet më të përdorura për marrjen e informacionit nga bashkia. Zyra e administratës dhe broshurat mbeten gjithashtu mjete informuese të përdorura nga të rinjtë.
- **Aktivitetet sociale, informuese, ndërgjegjëse, argëtuese dhe sportive** janë programet më të preferuara që të rinjtë do të donin të përfitonin nga Bashkia e Urës Vajgurore. Me prioritet nga të rinjtë janë vlerësuar edhe shërbimet e mëposhtme: Laborator, kompjutera, salla leximi, sisteme ngrohje.

ÇFARË MUND TË PËRFSHIHET NË BUXHETIN E VITIT 2021 TË BASHKISË SË URËS VAJGURORE PËR RININË?

Bashkia Urë Vajgurore, në përbushje të detyrimeve dhe përgjegjësi të saj për mirësimin e situatës së të rejave dhe të rinjve të Urës Vajgurore, në zbatim të Ligjit 75/2019 “Për rininë”, si dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015-2020, **mund të përfshijë në planifikimin buxhetor për vitin 2021 disa nga veprimet që përshkruhen në vijim:**

QËLLIMI	VEPRIMI / PROJEKTI	KOHËZGJATJA	TREGUES	DETAJIME MBI ROLIN E BASHKISË
1. Nxitja dhe pjesëmarrja e të rejave dhe të rinjve në proceset dhe vendimmarrjet demokratike	1.1. Krijimi i Këshillit Vendor të Rinisë, i parashikuar si një kompetencë e njësive të vetëqeverisjes vendore dhe në Ligjin 75/2019 “Për rininë” duke respektuar balancën gjinore si dhe përfaqësimin e të rejave dhe të rinjve nga grupe të pafavorizuara (persona me aftësi të kufizuara, minoriteti Rom, Egjiptjan, komuniteti LGBTI, etj).	- Shtator 2020 Krijimi i Këshillit Vendor të Rinisë, i kryesuar nga kryetari i Bashkisë dhe me përbërjen e 4-6 anëtarëve, ku të paktën gjysma e tyre të jenë përfaqësues të organizatave rinore dhe/ ose për të rinjtë. - 2020 - e në vijim: Aktivizimi i këtij Këshilli në mbledhjet dhe proceset vendimmarrëse të bashkisë.	- Lista e antarëve/eve të Këshillit Vendor të Rinisë, publikuar në faqen e internetit të bashkisë Urë Vajgurore. - Pjesëmarrja dhe diskutimi i tyre pasqyruar në proces-verbalet e mbledhjeve përkatëse.	Bashkia Urë Vajgurore mer masa që Këshillin Vendor të Rinisë ta ketë të ngritur dhe aktiv gjatë vitit 2020. Bashkia Urë Vajgurore e ka të përcaktuar në Planin e Kujdesit Social Lokal përfshirjen e të rinjve në aktivitete vullnetare të organizuara nga klubet rinore.

QËLLIMI	VEPRIMI / PROJEKTI	KOHËZGJATJA	TREGUES	DETAJIME MBI ROLIN E BASHKISË
	1.2. Përfshirja e dimensionit gjinor dhe rëndësisë së pjesëmarrjes së barabartë në përfaqësimin dhe jetën politike, në sesione për edukimin qytetar, në shkollat publike (të mesme)	Gjatë gjithë viteve 2020 – 2021	<ul style="list-style-type: none"> – Numri i aktiviteteve me fokus diskriminimin gjinor dhe përfshirjen e rinisë në vendimmarrje, të organizuara nga bashkia në 4 shkollat e mesme të Bashkisë. – Numri i të rejave dhe të rinjve të pranishëm si dhe që japin mendim në mbledhjet e Këshillit Bashkiak apo seancat/ dëgjесat publike që organizon bashkia për çështje të ndryshme. 	Bashkia Urë Vajguore respekton barazinë gjinore në përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, si dhe organizon aktivitete në lidhje me fokusin gjinor në bashkëpunim me shkollat e mesme të qytetit.
	1.3. Takime sensibilizuese me të rejtat e zonave rurale dhe urbane, si dhe me të rejtat me aftësi të kufizuara, mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë të tyre në procesin e votimit (individual e të lirë), në zgjedhjet vendore dhe qendrore.	Përgjatë viteve 2019-2023	<ul style="list-style-type: none"> – Numri i takimeve sensibilizuese të organizuara. – Numri i pjesëmarrës/eve disgreguar sipas zonave, moshës, aftësive dhe njësive administrative. 	Bashkia Urë Vajguore të ketë në vëmendje realizimin e takimeve sensibilizuese me të rinjtë në zonat rurale dhe urbane lidhur me procesin e votimit. Bashkia Urë Vajguore e ka të përcaktuar në Planin e Kujdesit Social Lokal organizimin e aktiviteteve edukuese dhe sensibilizuese për të rinjtë në shkolla kundër diskriminimit dhe bullizmit (10 fushata dhe 20 aktivitete).
2. Nxitja e punësimit të të rejave dhe të rinjve përmes politikave efektive të tregut të punës	2.1. Vlerësimi i kërkesës së tregut të punës dhe traditës apo nevojave specifike të Urës Vajguore, në lidhje me kurset e formimit profesional që mund të ofrohen në këtë Bashki.	Përgjatë viteve 2019-2023	<ul style="list-style-type: none"> – Raporti i vlerësimit të situatës. – Propozimet drejtuar Zyrës Rajonale të Punësimit (ZRP) mbi kurset e reja të formimit profesional që duhet të hapen në Urën Vajguore. – Numri i kurseve të reja të hapura. 	Bashkia Urë Vajguore e ka të përcaktuar në Planin e Kujdesit Social Lokal rolin ndërmjetësues për trajnimin dhe kurseve të formimit profesional për të rinjtë e papunë (80 të rinj përfundojnë kurse profesionale);
	2.2. Organizimi i takimeve sensibilizuese me të rejtat dhe të rinjtë mbi rëndësinë e ndjekjes së kurseve të formimit profesional të bazuara në nevojat dhe specifikat e zonës.	Përgjatë viteve 2019-2023	<ul style="list-style-type: none"> – Numri i takimeve të organizuara në shkolla. – Numri i të rejave dhe të rinjve pjesëmarrës/e në këto takime. – Numri i të rejave dhe të rinjve të regjistruar/a në kurset e formimit profesional. 	Bashkia Urë Vajguore e ka të përcaktuar në Planin e Kujdesit Social Lokal ofrimin e shërbimeve ndërmjetësuese nëpërmjet zyrës së punës për punësimin e të rinjve të papunë.

QËLLIMI	VEPRIMI / PROJEKTI	KOHËZGJATJA	TREGUES	DETAJIME MBI ROLIN E BASHKISË
	2.3. Mbështetja e aktiviteteve që nxisin vetëpunësimin e të rejave dhe të rinjve nga zonat rurale.	Përgjatë viteve 2020-2021	– Numri i aktiviteteve vetëpunësuese të mbështetura. – Numri i të rejave dhe të rinjve të vetëpunësuar/a.	Bashkia Urë Vajgurore mund të mbështesë me grante ose incentiva fiskale të rinjtë që vetëpunësohen në zonat rurale.
	2.4. Seminare informuese dhe trajnuese me nxënës/et e shkollave të mesme mbi rëndësinë e të sfiduarit të stereotipeve gjinore në punësim.	Përgjatë viteve 2020-2021	– Numri i seminareve të organizuara. – Lista e pjesëmarrës/eve disagreguar sipas seksit, moshës, klasës dhe njëjësive administrative.	Bashkia Urë Vajgurore mund të luajë rolin e facilitatorit.
	2.5. Panairi i ideve në kuadër të "Ditës Botërore të Aftësive të të rejave dhe të rinjve" ⁴ , bazuar në trajnimet e formimit profesional të ofruara mbi bazën e nevojave dhe karakteristikave të zonës.	15 Korrik 2020 15 Korrik 2021	– Panairi i organizuar në bashkëpunim me ZRP. – Numri i ideve të prezantuara. – Numri i të rejave dhe të rinjve pjesëmarrës/e.	Bashkia Urë Vajgurore mund të luajë rolin e facilitatorit.
3. Nxitja e përfshirjes së të rejave dhe të rinjve në aktivitete mjedisore dhe turistike	3.1. Nxitja e pjesëmarrjes aktive të të rejave dhe të rinjve në hartimin dhe monitorimin e politikave mjedisore dhe turistike në nivel local, me fokus pazarin e qytetit.	Përgjatë viteve 2020-2021	– Numri i të rejave dhe të rinjve që marrin pjesë aktivisht në seancat e Këshillit Bashkiak, dëgjesat publike apo aktivitetet mbi mjedisin, turizmin të organizuara nga bashkia.	Në fokus të projekteve të Bashkisë Urë Vajgurore të jetë planifikimi për politikat mjedisore dhe turistike.
	3.2. Aktivitete pastrimi, pyllëzimi, riciklimi, promovimi turizmi me qëllim rritjen e sensibilitetit të të rejave dhe të rinjve, si dhe komunitetit në tërësi mbi mbrojtjen e mjedisit.	Përgjatë viteve 2020-2021	– Numri i aktiviteteve sensibilizuese të organizuara. – Numri i aktiviteteve për promovimin e turizmit të organizuara. – Numri i pemëve të mbjella dhe sasia e plehrave të grumbulluara apo ricikluara.	Kjo është në fokus të punës së Bashkisë.
	3.3. Aktivitete sensibilizuese mbi mjedisin dhe ndikimin e tij në shëndetin e gjeneratës së re.	Përgjatë viteve 2020-2021	– Numri i aktiviteteve të zhvilluara. – Numri i të rejave dhe të rinjve pjesëmarrës/e.	Kjo është në fokus të punës së Bashkisë.
	3.4. Aktivitete me të rinjtë që janë larguar nga bashkia për arsye studimesh ose të tjera, me qëllim angazhimin e tyre në aktivitetet që promovojnë kulturën, turizmin dhe vlerat e bashkisë së Urës Vajgurore.	Përgjatë viteve 2020-2021	– Numri i aktiviteteve të zhvilluara. – Numri i të rejave dhe të rinjve pjesëmarrës/e.	Bashkia Urë Vajgurore vë theksin në bashkëpunimin me organizatat për të rinjtë e organizatat rinore shqiptare në diasporë për të mbajtur komunikimin me të rinjtë që janë larguar nga bashkia për arsye studimesh ose të tjera, në mënyrë që të promovojnë vlerat turistike dhe kulturore të Bashkisë përtej kufijve shqiptarë.

QËLLIMI	VEPRIMI / PROJEKTI	KOHËZGJATJA	TREGUES	DETAJIME MBI ROLIN E BASHKISË
4. Nxitja e përfshirjes së të rejave dhe të rinjve në aktivitete artistike e kulturore	4.1. Mbështetje për grupet e reja rinore kulturore dhe artistike (këngë, teatër, animacione) të krijuara nga të rejtat dhe të rinjtë e shkollave të Urës Vajguore dhe përfshirja e tyre në ngjarje apo festa të rëndësishme të qytetit.	Përgjatë viteve 2020-2021	- Numri i grupeve të reja rinore të mbështetura. - Numri i aktiviteteve të bashkisë në të cilat janë të ftuara dhe kanë performuar këto grupe rinore.	Përfshirja e të rinjve në aktivitete artistike-kulturore.
	4.2. Promovimi i jetës artistike dhe kulturore përmes organizimit të aktiviteteve artistike-kulturore në zonat urbane dhe në zonat rurale.	Përgjatë viteve 2020-2021	- Numri i aktiviteteve artistike-kulturore të organizuara me mbështetjen e bashkisë, në zonat urbane dhe rurale, me grupet rinore.	Kjo është në fokus të punës së Bashkisë.
	4.3. Programe sensibilizuese në mediat lokale mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë të të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve në veprimtari sportive, artistike dhe kulturore, përfshirë edhe ato që tradicionalisht shihen si aktivitete kryesisht "femërore" ose "mashkullore".	Përgjatë viteve 2020-2021	- Numri i programeve të realizuara. - Përqindja e audiencës së arritur në varësi të shikueshmërisë televizive.	Planifikimi i një sërë projesh sportive nga Bashkia ku do t'u vihet theksi pjesëmarrjes së barazisë gjinore dhe promovimi i aktiviteteve të të rinjve.
5. Nxitja e përfshirjes së të rejave dhe të rinjve në aktivitete edukuese shëndetësore	5.1. Aktivitete që promovojnë një kulturë të hapur dhe të lirë rreth shëndetit seksual, për të ulur stigmatizmin dhe diskriminimin.	Përgjatë viteve 2020-2021	- Numri i aktiviteteve të zhvilluara në shkollat e qytetit dhe në zonat rurale. - Numri i të rejave dhe të rinjve që marrin pjesë.	Bashkia Urë Vajguore mund të luajë rolin e facilitatorit.
	5.2. Krijimi dhe mbështetja e grupeve të "edukatorëve bashkëmohatarë" ("peer education groups") për nxitjen e organizimit të aktiviteteve edukuese shëndetësore mes të rejave dhe të rinjve në zonat rurale, si dhe në komunitetin Rom, Egjiptjan, LGBTI, etj.	Përgjatë viteve 2020-2021	- Grupet e "edukatorëve bashkëmohatarë" të krijuara. - Numri i aktiviteteve të organizuara nga grupet e "edukatorëve bashkëmohatarë" me të rejtat dhe të rinjtë e zonave apo komuniteteve të caktuara.	Bashkia Urë Vajguore mund të luajë rolin e facilitatorit.
	5.3. Konkurse mes katër shkollave të mesme mbi rolin e qeverisjes vendore në çështje të shëndetit seksual dhe riprodhues.	Gjatë ditëve dedikuar shëndetit përgjatë viteve 2020-2021	- Numri i aktiviteteve të zhvilluara në katër shkollat e mesme. - Numri i të rejave dhe të rinjve që marrin pjesë.	Bashkia Urë Vajguore mund të luajë rolin e facilitatorit.

4. Për të ritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e investimit në zhvillimin e aftësive të të rejave dhe të rinjve, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara vendosi në Rezolutën A/RES/69/145 që data 15 Korrik të njihet si Dita Botërore e Aftësive të të rejave dhe të rinjve (World Youth Skills Day). Për më shumë informacion vizitoni faqen: <http://www.un.org/en/events/youthskillsday/index.shtml>

QËLLIMI	VEPRIMI / PROJEKTI	KOHËZGJATJA	TREGUES	DETAJIME MBI ROLIN E BASHKISË
6. Nxitja e përfshirjes së të rejave dhe të rinjve në aktivitete për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qendrueshëm (Sustainable Development Golas – SDGs)	6.1. Aktivitete informuese mbi SDG-të me qëllim njohjen e tyre dhe sensibilizimin e të rejave dhe të rinjve mbi rolin që mund dhe duhet të luajnë për përbushjen e këtyre objektivave. 6.2. Hartimi i planit të veprimeve për përfshirjen e të rejave dhe të rinjve në arritjen e SDG-ve. Zbatimi i planit të hartuar, duke ofruar mbështetjen e duhur financiare, infrastrukturore, etj.	Përgjatë viteve 2020-2021	- Numri i aktiviteteve me fokus SDG-të, të organizuara nga bashkia në bashkëpunim me Rrjetin e Organizatave “Zëri i të rinjve” dhe me katër shkollat e mesme të qytetit.	Bashkia Urë Vajguore mund të luajë rolin e facilitatorit.
		Përgjatë viteve 2020-2021	- Dokumenti i Planit të Veprimeve për arritjen e SDG-ve përmes kontributit të të rejave dhe të rinjve. - Numri i iniciativave të financuara nga bashkia, për t’u zbatuar nga të rejtat dhe të rinjtë në kuadër të SDG-ve.	Bashkia Urë Vajguore bashkëpunon me shkollat e mesme.

ÇFARË HAPASH DUHET TË HEDHË BASHKIA PARALELISHT ME PËRFSHIRJEN NË BUXHETIN E VITIT 2021 TË DISA PREJ VEPRIMEVE TË PROPOZUARA MË SIPËR?

- Të marrë masa për ngritjen e Këshillit Vendor të Rinisë në përbërjen e të cilit të ketë përfaqësim të barabartë jo vetëm në gjini, por edhe duke respektuar karakteristika të tjera të tilla si vendbanimi, moshë, etnia, nevojat e veçanta, orientimi seksual, etj.
- Të marrë masa të menjëhershme për të siguruar një bazë të saktë të dhënash (databazë) në lidhje me numrin e të rejave dhe të rinjve në qytet dhe zonat rurale pjesë e territorit të bashkisë, duke siguruar që kjo bazë të dhënash të përbajë detaje mbi gjininë, moshën, nevojat e veçanta të tyre, etninë, etj.
- Të bashkëpunojë me Rrjetin e Organizatave “Zëri i të Rinjve” me qëllim ofrimin e modelit për nxitjen e krijimit të grupeve dhe shoqatave rinore, nga të rejtat dhe të rinjtë e qytetit dhe të zonave rurale pjesë e territorit të bashkisë.
- Të organizojë sesione të hapura dhe dëgjesa publike me fokus të veçantë të rejtat dhe të rinjtë dhe nevojat e tyre. Për të siguruar pjesëmarrjen në këto sesione e dëgjesa, të organizojë fillimisht takime të shkurtra informuese në shkollat e qytetit dhe të zonave rurale, ku të ftohen të rejtat dhe të rinjtë të bëhen pjesë e dëgjesave që do të organizojë bashkia. Në këto takime duhet të paraqitet dhe kalendari i dëgjesave që mendohet të organizohen. Një kopje e këtij kalendari me datat, oraret dhe vendin e organizimit të këtyre dëgjesave, duhet të publikohet edhe në faqen e internetit të bashkisë.
- Të marrë masa për të caktuar një specialist/e që në përshkrimin e punës së tij/saj të ketë detyra që lidhen specifikisht me çështje të shëndetit.
- Të marrë masa që të koordinojë aktivitetet shëndetësore, edukuese e kulturore me prioritetet që lidhen me rininë në këto drejtime. Të mundësojë shkëmbime eksperiencash me bashki të tjera ku grupimet rinore janë më aktive.
- Të përfshijë aksionet/ veprimtaritë e mësipërme në plan sektorial të veprimit për rininë, për të cilin është duke punuar. Në këtë plan duhet të përmblidhen të gjitha veprimet e parashikuara në dokumenta të tjerë zhvillimorë të bashkisë, por edhe veprime të tjera të domosdoshme për adresimin e çështjeve rinore në fusha të ndryshme. Ky plan veprimi duhet të mbështetet në Ligjin 75/2019 “Për rininë”, Planin Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015-2020 si dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm 2018-2020 të Bashkisë Urë Vajguore (pjesë e këtyre veprimeve janë dhënë në tabelën më sipër me sugjerime për veprimet që duhet të përfshihen në buxhetin e vitit 2021 të bashkisë Urë Vajguore, me fokus rininë).
- Të marrë masa që në takimet dhe dëgjesat për përfundimin e buxhetit vjetor 2021, të sigurojë pjesëmarrjen e të rejave dhe të rinjve nga grupe të ndryshme (përfshirë edhe nga grupet e pafavorizuara si Romë, Egjiptjanë, PAK, LGBTI, etj.). Bashkëpunimi me Rrjetin e Organizatave “Zëri i të Rinjve” është i domosdoshëm në këtë drejtim, sidomos për të siguruar pjesëmarrjen e të rejave dhe të rinjve nga grupet e ndryshme të sipërcituara, të rejave dhe të rinjve nga zonat rurale, etj.

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Mars 2020



Leave
No One
Behind

